



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 313/1 Prot.

Tiranë, më 16 / 02 / 2021

**V E N D I M**

**Nr. 28, Datë 16 / 02 / 2021**

Bazuar në pikën 11<sup>1</sup>, të nenit 33, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

**K O N S T A T O N:**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germat “a” dhe “c”, dhe pika 3 e këtij neni, nenit 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit, për të shqyrtuar çështjen e nisur kryesisht, lidhur me gjuhën e përdorur, në programin, Reality Show “REAL TALK me Aventurierët-Vali” të datës 24.07.2020 të publikuar në faqen web të televizionit Top-Channel.

Bazuar në Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në përfundim të procedurës së hetimit, Komisioneri ka dalë me Vendimin nr. 155, datë 30.10.2020, me anë të të cilit ka vendosur: *“Konstatimin e diskriminimit të shtetasve me sindromën down, në formën e shqetësimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e televizionit Top Channel”*. Në pikën 2 të këtij vendimi, Komisioneri ka vendosur që: *“Televizioni Top Channel, të dalë me një deklaratë publike (verbale apo të shkruar) me anë të së cilës të distancohet nga përdorimi i një gjuhe të tillë e cila*

<sup>1</sup> Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

*paragjykon haptazi, cënon dhe prek dinjitetin e personave me sindromën down”, si masë konkrete për të përmirësuar situatën diskriminuese.*

Në datën 18.11.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet ligjore të miratuara me Ligjin nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>2</sup>. Meqënëse çështja objekt i këtij shqyrtimi administrativ është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 124/2020, atëherë Komisioneri vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet sipas parashikimeve të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të pandryshuar.

Lidhur me sa më sipër, nëpërmjet shkresës nr. 23, datë 06.01.2021, Komisioneri ka kërkuar informacion nga televizioni Top-Channel lidhur me masat e ndërmarra prej saj për zbatimin e Vendimit nr. 155, datë 30.10.2020, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Pavarësisht faktit që Televizioni Top Channel ka marrë dijeni<sup>3</sup> mbi shkresat e mësipërme, nuk ka vënë në dispozicion të Komisionerit, asnjë informacion lidhur me plotësimin e pikës 2 të vendimit të sipërcituar.

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në konkluzionin se Televizioni Top Channel është në shkelje të parashikimeve të bëra në pikën 11, të nenit 33, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pasi nuk ka zbatuar Vendimin nr. 155, datë 30.10.2020 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 32/1, germa “ç”, neni 33, pikat 11, 12, 13/b dhe 14, nenit 33/1 të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Televizioni Top Channel, të gjobitet në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.
2. Gjyba të derdhet në Buxhetin e Shtetit, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, mbi masën administrative. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë,

---

<sup>2</sup> Ligji nr.124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.191, datë 03.11.2020.

<sup>3</sup> Lajmërim marrje poste nr. RR 463 107 622 AA, datë 03.11.2020 dhe lajmërim marrje poste nr. RR 616 630 195 AA, datë 07.01.2021.

për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.

3. Zbatimi i Vendimit nr. 155, datë 30.10.2020 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda shtatë ditëve nga marrja dijani për sanksionet, sjell shfuqizimin e tij.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**